



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIK
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY

QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z. /S. 02 Nr./Br./No. 17998
Nr. ifaq. 01 Data 03/07/2026
Br. Str. Datum
No. Pa. Date
KAMENICE - KAMENICA

Zyra e Prokurimit

Sh.02.Nr.135 datë:02.07.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, datë 20.10.2022, Kontratës Sh.02. Nr. 10536 datë 22.04.2026, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxher i kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizim me çanta shkollore**", me numër të kontratë **KM653-26-3640-1-2-1** si në vijim:

1.1. Z. Edmond Kastrati (Drejtorja e Arsimit), **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.


2.Menaxheri i kontratës obligohet të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në përputhje me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe me Manualet për Përdorimin e Modulit për Menaxhimin e Kontratave.

3. Menaxheri i kontratës obligohet të dërgojë raporte të rregullta për procesin e përmbushjes së kontratës.

4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- Z. Edmond Kastrati (DKA) dhe
- QSHQ-arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY

QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 12999
Nr.faq. 1 Data 03/07
Rr. Qr. Data
Faq. Pg. Data
KAMENICE - KAMENICA 2026

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Prokurimit

Sh.02 Nr.134 datë. 02.07.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, datë 20.10.2022, Kontratës Sh.02 Nr.13663 e datës 20.05.2026, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohen menaxhere e kontratës dhe mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës me titull: **"Furnizimi me inventar kuzhine për shtëpinë e Komunitetit"**, me numër të kontratës **KM 653-26-2762-1-3-6** si në vijim:

1.1. znj. Xhevrije Ramnabaja (Shtëpia e Komunitetit) **CAKTOHET** menaxhere e Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

1.2 znj. Kaltrina Thaqi (Shtëpia e Komunitetit) **CAKTOHET** mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e menaxheres së kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:



- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- znj. Xhevrije Ramnabaja (Shtëpia e Komunitetit) ;
- znj. Kaltrina Thaqi (Shtëpia e Komunitetit)
- QSHQ-arkiv



Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Sh.02 Nr.125, datë: 02.07.2026

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Arsyetimi Sh.02.Nr.17708 i datës 01.07.2026, neni 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR LEJIMIN E PAGESËS NË VLERË PREJ 619.50 €

1. Lejohet pagesa e faturës Nr. 150.06 e datës 17.06.2026, në shumë prej 619.50 € për shpenzimet e krijuara në "PIKA 5A" SH.P.K, në Gjilan, me rastin e ditës së Çlirimit të Kamenicës "18 Qershorit", DKRS ka organizuar aktivitete të shumta kulturore e sportive, ndër aktivitetet ishte edhe ekspozita e fotografive "Gratë në Rrugën e Lirisë", ku për këtë ekspozitë u printuan dhe u vendosën nëpër korniza 150 fotografi të grave që kanë qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor 85029 i DKRS-së, në xhirollogarinë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkangjitur në shtojcë të këtij vendimit.
3. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në Kamenicë në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
4. Vendimit i bashkangjitet Arsyetimi Sh.02.Nr.17708 i datës 01.07.2026, fatura Nr. 150.6 e datës 17.06.2026, në shumë prej 619.50 €, dhe fotografi lidhur me aktivitetin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.


Vendim t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Nënkyetares;
- Zyrës për Informim;
- DKRS-së;
- DBF-së; dhe
- QSHQ – Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit (Nr. 03/L-040) për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008), nenin 44 të Ligjit për Procedurë e Përgjithshme Administrative, nenin 83, paragrafi 1, nënparagrafët 1.3 dhe 1.4, të Rregullores Sh. 01.Nr. 5300 të datës 16.02.2023 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha, Kërkesës Sh.02.18303 të datës 06.07.2026, e parashtruar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Programi I Korrje-Shirjeve për vitin 2026 dhe njëkohësisht formohet Komisioni Komunal me këtë përbërje:
 - 1.1 Sevdai Bojku (DBPZHR) – Kryesues i komisionit;
 - 1.2 Almedina Kryeziu (DBPZHR) – anëtar;
 - 1.3 Naser Vllasi (DSHPAEI) – anëtar;
 - 1.4 Musa Ismajli (DSHPAEI) – anëtar;
 - 1.5 Besnik Kovani (DAP) – anëtar;
2. Anëtarët e komisionit si në pikën 1 (një) të këtij Vendimi janë përgjegjës për realizimin e detyrave të mëposhtme:
 - 2.1. Të bëjnë pranimin teknik të autokombajnave (makinave shirëse) dhe të japin pëlqimin për funksionimin e tyre;
 - 2.2. Të përcjellin procesin e korrje-shirjes, nga fillimi deri te përfundimi;
 - 2.3. Të sigurohen se procesi i korrjeve zhvillohet në përputhje me rregulloren komunale në fuqi;
 - 2.4. Të kujdesen për respektimin e rendit të korrjes, parandalimin e derdhjes së drithit gjatë korrje-shirjes, si dhe të ndërmarin masa mbrojtëse për parandalimin e zjarreve, duke përfshirë edhe ndalimin e ndezjes së hamulloreve;
 - 2.5. Të sigurojnë respektimin e çmimit të përcaktuar për korrje-shirje;
3. Qëllimi I formimit të Komisionit Komunal është që të përcillet dhe të menaxhohet në mënyrë sa më të rregullt, të sigurt dhe efikas procesi I korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Kamenicës për vitin 2026.
4. Komisioni mban përgjegjësi për zbatimin e këtij Vendimi, dhe për punën e vet i raporton Kryetarit të Komunës, i cili mbikëqyr zbatimin e këtij Vendimi.
5. Mandati i Komisionit Komunal vazhdon deri në përfundimin e plotë të procesit të korrje-shirjeve për vitin 2026, përfshirë të gjitha veprimet dhe raportimet e nevojshme për zbatimin e programit.

6. Vendimit I bashkangjitet Kërkesa Sh. 02. 18303 të datës 06.07.2026 e parashtruar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dërgohet; , QSHQ-arkivit.

- Zyrës së Kryetarit
- Zyrës për Informim
- Anëtarëve të Komisionit
- Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- QSHQ-arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Nr./Br./No.
Data
Datum
Date

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.126, datë: 07.07.2026

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 17, shkronja r) dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), në nenin 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/2016), si dhe në nenin 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, me qëllim të formimit të Këshillit Organizativ për organizimin, planifikimin, koordinimin dhe sigurimin e mbarrëvajtjes së aktiviteteve të edicionit të 4-të të festivalit "Kamenica Summer Fest 2026", Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

për formimin e Këshillit Organizativ për organizimin e edicionit të 4-të të festivalit "Kamenica Summer Fest 2026"

1. Me këtë Vendim formohet Këshilli Organizativ për organizimin, planifikimin, koordinimin dhe sigurimin e mbarrëvajtjes së aktiviteteve të edicionit të 4-të të festivalit "Kamenica Summer Fest 2026".
2. Këshilli Organizativ përbëhet nga:
 - 2.1. Afrim Dërvishi (DKRS) – Kryesues;
 - 2.2. Vaxhid Rexhepaj (ZK) – Koordinator i aktiviteteve;
 - 2.3. Edon Dërmaku (DZHED) – Zëvendësues i Kryesuesit;
 - 2.4. Lidiona Marovca (ZK) – Përgjegjëse për mbarrëvajtjen e aktiviteteve;
 - 2.5. Rona Myrtaj Beqiri (ZK) – Përgjegjëse për informim dhe përshkrim të aktiviteteve;
 - 2.6. Arta Bajralija (Nënkryetare e Komunës) – Përgjegjëse për monitorimin dhe përcjelljen e zbatimit të programit të festivalit;
 - 2.7. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) – pjesë përbërëse e Këshillit Organizativ;
 - 2.8. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë (DZHED) – pjesë përbërëse e Këshillit Organizativ;
 - 2.9. Praktikantët dhe asistentët administrativë të angazhuar në drejtoritë komunale – mbështetje në realizimin dhe mbarrëvajtjen e aktiviteteve.
3. Këshilli Organizativ ka për detyrë:
 - 3.1. Të organizojë dhe koordinojë aktivitetet e edicionit të 4-të të festivalit "Kamenica Summer Fest 2026";
 - 3.2. Të hartojë agjendën dhe programin e festivalit;
 - 3.3. Të caktojë nëngrupe organizative sipas nevojës për realizimin e aktiviteteve të veçanta;
 - 3.4. Të bashkëpunojë me drejtoritë komunale, organizatat joqeveritare, institucionet, bizneset dhe partnerët tjerë për realizimin sa më të suksesshëm të festivalit.

4. Këshilli Organizativ, nga data e themelimit të tij, zhvillon takime të rregullta koordinuese çdo ditë në ora 09:00, me qëllim të planifikimit, koordinimit dhe përcjelljes së realizimit të aktiviteteve të festivalit. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen anëtarët e Këshillit Organizativ të përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, sipas detyrave dhe përgjegjësisë të përcaktuara.
5. Mandati i Këshillit Organizativ zgjat nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi deri në përfundimin e të gjitha aktiviteteve të edicionit të 4-të të festivalit "Kamenica Summer Fest 2026", përfshirë përmbylljen e organizimit dhe përmbushjen e detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dorëzohet:


- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Nënkryetares;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Këshillit Organizativ;
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë;
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport; dhe
- QSHQ – arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PER SHERBIME ME QYLLIMIN CENTAR ZA USHTRIMET CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. 02	Nr./Br./No. 18643
Nr. i faq. 2	Data 08/07/26
Br. Str. No. Pg.	Datum. Date
KAMENICE - KAMENICA	



Zyra e Kryetarit

Sh.02Nr.127, datë:08.07.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr. 04/2020 për Kujdesin Parësor Shëndetësor, të plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ të MSH-së Nr.01/2026, nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 dhe nenit 12 të Statutit Sh.01.Nr.10370, të datës 03.04.2024, të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Shaban Geci" në Kamenicë, nenit 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të Memorandumit të Bashkëpunimit Sh.08.Nr.35566, të datës 12.11.2024, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Shoqatës së të Drejtave të Pacientëve në Kosovë, Ftesës Publike Sh.04.Nr.9789, të shpallur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale më datë 15.04.2026, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja j), nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b), dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, si dhe bazuar në kërkesën e datës 07.07.2026, të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale përmes e-mailit zyrtar, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pacientëve

1. Formohet Komisioni përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve dhe përzgjedhjen e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pacientëve nga radhët e aplikantëve që kanë aplikuar sipas Ftesës Publike Sh.04.Nr.9789, të shpallur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale më datë 15.04.2026, në këtë përbërje:
 - 1.1. Durim Biqkaj (Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale), Kryesues;
 - 1.2. Filloreta Rexha (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare), anëtare;
 - 1.3. Sherafedin Vranja (Shoqëria Civile), anëtar.
2. Komisioni obligohet të shqyrtojë aplikimet dhe të realizojë procedurën e përzgjedhjes së pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pacientëve, në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Ftesën Publike Sh.04.Nr.9789, të shpallur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale më datë 15.04.2026.
3. Mandati i Komisionit zgjat deri në përmbylljen e procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Pacientëve, në përputhje me këtë vendim.
4. Komisioni është i obliguar që gjatë ushtrimit të detyrave të tij të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë këtë fushë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Komisioni i formuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, ndërsa mbikëqyrjen e zbatimit të tij e ushtron Kryetari i Komunës.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Nënkryetares;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; dhe
- QSHQ – arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.129, datë:09.07.2026

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17, shkronja f), dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7, paragrafi 6, nënparagrafët 6.1 dhe 6.2, nenit 8 dhe nenit 27 të Rregullores Sh.01.Nr.31251, datë 29.09.2022, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Sh.01.Nr.8620, datë 14.04.2025, si dhe nenit 5, paragrafi 5.1, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b), dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, me qëllim të shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave për subvencione në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM

Për emërimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për subvencione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

1. FORMOHET Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me mandat prej dy (2) vitesh, me këtë përbërje:
 - 1.1. Azemine Maliqi (DKRS) – Kryesuese;
 - 1.2. Arben Hoxha (DBF) – Anëtar;
 - 1.3. Jadranka Ilic (DKRS) – Anëtare;
 - 1.4. Shehat Rudhani (DKRS) – Anëtar;
 - 1.5. Valdete Berisha Murina (Zyra e Kryetarit) – Anëtare;
 - 1.6. Venera Dërmaku - Rexha (DKRS) – Anëtare rezervë (Zëvendëson anëtarin e rregullt në rast të konfliktit të interesit).
2. Komisioni i formuar sipas pikës 1 të këtij vendimi ka këto përgjegjësi:
 - 2.1. Shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave/aplikacioneve brenda afatit prej 30 ditë pune nga e pranimit të kërkesave individuale jashtë thirrjes publike;
 - 2.2. Verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe rregulloret komunale në fuqi.
 - 2.3. Hartimin e procesverbaleve nga takimet dhe aktivitetet e vendimmarrjes;
 - 2.4. Hartimin dhe paraqitjen e rekomandimit për Kryetarin e Komunës lidhur me aprovimin ose refuzimin e kërkesave për subvencione, për qëllim të vendimmarrjes.

4. Mandati i komisionit zgjat dy (2) vite nga data e nënshkrimit të këtij vendimi. Anëtarët mbajnë përgjegjësi të plotë për zbatimin e drejtë të kushteve dhe kriterëve të subvencioneve.
5. Për zbatimin e këtij vendimi përgjegjës është Komisioni i emëruar sipas pikës 1 të këtij vendimi, ndërsa mbikëqyrjen e zbatimit e ushtron Kryetari i Komunës.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me vendim të njoftohet: Zyra e Kryetarit, Zyra e Nënkryetares, Zyra e Informimit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Anëtarëve të Komisionit dhe Q.SH.Q - arkivi.



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY


QENDRA PER SHERBIME ME QYTETARE
CENTAR ZA USLUGU GRADANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 19200
Nr. i faq. 01 Data 13/07
Br. Str. Datum 2026
No. Pg. Date
KAMENICE - KAMENICA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Prokurimit

Sh.02 nr.139 datë: 10.07.2026

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 22 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenin 10 paragrafi 10.1 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe bazuar në kërkesën të datës 10.07.2026 përmes email zyrtar të Drejtorisë së Kulturës Rinise dhe Sportit **"Servisimi i projektorit në Shtëpinë e Kulturës "Isa Kastrati" në Kamenicë."** dhe nenin 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

V E N D I M

1. CAKTOHET, z. **Afrim Dervishi**, Zyrtar Autorizues për projektin: **"Servisimi i projektorit në Shtëpinë e Kulturës "Isa Kastrati" në Kamenicë."** Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
2. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit të Zyrtari i Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit, së bashku me kopjen e Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërinë për Disponueshmërinë e Fondeve.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi është përgjegjës Zyrtari Autorizues, z. **Afrim Dervishi**, për projektin: **"Servisimi i projektorit në Shtëpinë e Kulturës "Isa Kastrati" në Kamenicë."**
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.


Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Afrim Dervishi (Drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport); dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Prokurimit

Sh.02.Nr.140 datë: 13.07.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, datë 20.10.2022, Kontratës Sh.02 Nr. 14200 e datës 28.05.2026, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës me titull: **"Furnizim me set mbuloje për fëmijë- çerdhe"**, me numër të kontratës **KM 653- 26-3761-1-3-6** si në vijim:
 - 1.1. **Z. Visar Krasniqi (DKA), ÇAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 **Z.Edmond Kastrati (DKA), ÇAKTOHET** mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Visar Krasniqi (DKA);
- z. Edmond Kastrati (DKA); dhe
- QSHQ-arkiv

Kryetari i Komunës


Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z./IS. 02 Nr./Br./No. 19260
Nri/faq. 2 Data: 13/07/26
Br./Str. 2 Datum: 13/07/26
KAMENICË - KAMENICA

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.130, datë:13.07.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20, datë 21 qershor 2016), nenit 5, paragrafi 3, si dhe neneve 14 dhe 28 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja d), nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b), dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, si dhe në zbatim të pikës 4 dhe pikës 9 të Vendimit Nr. 3662/26 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të datës 29.06.2026, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr:

V E N D I M

për themelimin e Komisionit për inventarizimin e drunjve urbanë në territorin e Komunës së Kamenicës

1. Me këtë Vendim themelohet Komisioni për inventarizimin e drunjve urbanë në territorin e Komunës së Kamenicës, me qëllim të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi Nr.3662/26 i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të datës 29.06.2026.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi themelohet Komisioni për inventarizimin e drunjve urbane, Komisioni përbëhet nga:
 - 2.1. Almedina Kryeziu Spahiu (DBPZHR), Kryesuese;
 - 2.2. Bektesh Dërmaku (DBPZHR), Anëtar;
 - 2.3. Musah Ismajli (DSHPAIE), Anëtar;
 - 2.4. Kaltrina Kadriu (DBPZHR), Anëtare;
 - 2.5. Vullnet Ajvazi, (i angazhuar nga Komuna e Kamenicës në bazë të marrëdhënies kontraktuale për realizimin e projektit), Anëtar.
3. Komisioni obligohet të realizojë inventarizimin e drunjve të vjetër urbanë, drunjve të parqeve dhe drunjve rreshtorë urbanë përgjatë trotuareve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Kamenicës, duke evidentuar dhe regjistruar të dhënat për secilin dru, përfshirë identifikimin, koordinatat gjeografike, gjendjen shëndetësore, moshën e përafërt dhe nevojat për ndërhyrje për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e gjendjes së tyre. Procesi zhvillohet në përputhje me Vendimin Nr. 3662/26 të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të datës 29.06.2026, legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, nën mbikëqyrjen e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe sipas Udhëzuesit Teknik përkatës. Pas përfundimit të inventarizimit, Komisioni harton regjistrin e inventarizimit dhe raportin përfundimtar, të cilat ia paraqet Kryetarit të Komunës.

4. Të gjitha drejtoritë komunale obligohen t'i ofrojnë Komisionit dokumentacionin, të dhënat dhe mbështetjen e nevojshme për realizimin e procesit të inventarizimit, ndërsa Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia, koordinon zbatimin e këtij Vendimi dhe bashkëpunimin me Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe institucionet kompetente.
5. Drejtoritë komunale nuk mund të ndërmarrin veprime që përfshijnë prerjen, krasitjen ekstreme ose zhvendosjen e drunjve urbanë të mbrojtur, përveç në rastet dhe sipas procedurave të përcaktuara me Vendimin Nr. 3662/26 të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të datës 29.06.2026, si dhe me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.
6. Komisioni obligohet ta përfundojë procesin e inventarizimit brenda afatit prej shtatëdhjetë e pesë (75) ditësh dhe, pas përfundimit të tij, t'ia dorëzojë Kryetarit të Komunës raportin përfundimtar, si dhe të sigurojë përcjelljen e të dhënave të inventarizimit në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), në përputhje me Vendimin Nr. 3662/26 të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të datës 29.06.2026, dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.
7. Bazuar në të dhënat e inventarizimit, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia obligohen të planifikojnë dhe zbatojnë masa të mirëmbajtjes, trajtimit dhe kontrollit periodik të gjendjes së drunjve urbanë në territorin e Komunës së Kamenicës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe regjistrin e inventarizimit.
8. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen anëtarët e Komisionit, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia, si dhe drejtoritë komunale të Komunës së Kamenicës, secila sipas kompetencave të saj.
9. Vendimit i bashkëngjitet Vendimi Nr. 3662/26 i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i datës 29.06.2026.
10. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Nënkryetares;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
- Drejtorisë të Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia;
- QSHQ – arkivit.



Kryetar i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Prokurimit

Sh.02.Nr.152 datë:20.07.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, datë 20.10.2022, Kontratës Sh.02 Nr.19891 e datës 17.07.2026, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohen menaxher i kontratës dhe mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës me titull: “**Hartimi i Projekteve-Ri tenderim LOT 1- Hartimi i projekteve për Objekte ndertimore**”, me numër të kontratës **KM 653-26-4125-2-2-1/C808** si në vijim:

1.1. Z. Imran Morina (DIK), CAKTOHET menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

1.2 Znj. Amire Rexha Ismajli (DIK), CAKTOHET mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Imran Morina (DIK);
- z. Amire Rexha Ismajli (DIK); dhe
- QSHQ-arkiv

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Prokurimit

Sh.02 nr.157 datë: 28.07.2026

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 22 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenin 10 paragrafi 10.1 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe bazuar në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit me numër Sh.02. nr. 6939 e datës 17.03.2026 për projektin **“Furnizim me inventar për shkollë”** dhe nenin 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Visar Dërmaku**, Zyrtar Autorizues për projektin: **“Furnizim me inventar për shkollë”** Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
2. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit të Zyrtari i Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit, së bashku me kopjen e Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërinë për Disponueshmërinë e Fondeve.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi është përgjegjës Zyrtari Autorizues, **z.Visar Dërmaku**, për projektin: **“Furnizim me inventar për shkollë”**
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.


Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Visar Dërmaku (DKA); dhe
- Arkivi.



Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Prokurimit

Sh.02 nr.158 datë: 29.07.2026

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 22 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenin 10 paragrafi 10.1 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe bazuar në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit me numër Sh.02. nr. 6939 e datës 17.03.2026 për projektin **“Kolektori i ujërave atmosferike”** dhe nenin 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

V E N D I M

1. CAKTOHET, z. **Blerim Murina** Zyrtar Autorizues për projektin: **“Kolektori i ujërave atmosferike”** Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
2. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit të Zyrtari i Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit, së bashku me kopjen e Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërinë për Disponueshmërinë e Fondeve.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi është përgjegjës Zyrtari Autorizues, z. **Blerim Murina**, për projektin **“Kolektori i ujërave atmosferike”**
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Blerim Murina (DIK); dhe
- Arkivi.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj